

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** - Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Skender Çoçaj, me procesmbajtësen Birsen Kume - sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit Y. K., nga fshati G., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 243, par.2 të KPK-së, dhe shmangia nga tatimi nga neni 249 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së PTH në Prizren - PP.nr4676/12-II të datës 09.06.2014, në seancën e shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Metush Biraj, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij avokat A. R. me datë 02.07.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

### I akuzuari:

**Y. K.**, nga i ati J. dhe e ëma T. e vajzërisë H., i lindur me datën *data e lindjes...* nga fshati G. KK Suharekë, me vendbanim në Prizren në rrugën..., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion tregtar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## ËSHTË FAJTOR

I.Se nga data 13.04.2011 deri më dt. 25.07.2013, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave, të llojit të kazinove, apo lojërave të fatit siç përcaktohet me ligj, për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncensionin i organit kompetent, dhe ka realizuar të ardhura të kundërligjshme në këto vende:

- 1.Të hyrat në lokalin-bastoren "Euro Best" rruga ... Prizren, "Toto Sport" rruga .. në Prizren dhe "EGTK" në lartësi prej 107.990,00 euro
- 2.Të hyrat në lokalin-bastoren "Euro Best" Prizren, të realizuara në intervalin kohor shkurt 2010-shtator 2011, në lartësi prej 119.433,00 euro
- 3.Të hyrat në lokalin-bastoren "Toto Sport" në fsh. Zh., në periudhën kohore nëntor 2008, qershor 2011, prej 65.448,00 euro
- 4.Të hyrat në lokalin-bastoren "Euro Best" pa adresë, periudha kohore mars 2007, dhjetor 2012, prej 48.532,00 euro.
- 5.Të hyrat në lokalin-bastoren "Euro Best" tek q. në Prizren, gjatë kohës shkurt 2010, qershor 2010 prej 5.034,00 euro
- 6.Të hyrat në lokalin-bastoren "Euro Best" te q. në Prizren, në kohën mars 2011, qershor 2011 prej 37.164,00 euro
- 7.Të hyrat në lokalin- bastoren "Euro Best" në A. K. Prizren, shkurt 2010, qershor 2011 prej 35.792,00 euro.
- 8.Të hyrat në lokalin-bastoren "Euro Best" në fshatin L. K. Prizren, janar 2010, shtator 2011, prej 10.875,00 euro.

9. Të hyrat në lokal-in-bastoren "Euro Best" fsh. R. K. Prizren, shkurt 2010, qershor 2011, prej 16.641,00 euro.

10. Të hyrat në lokal-in-bastoren "Euro Best" fsh. Gj. K. Prizren, janar 2008, maj 2011, prej 49.922,00 euro.

11. Të hyrat në lokal-in-bastoren "Euro Best" fsh. B. K. D., dhjetor 2007, shkurt 2008, prej 4.395,00 euro.

12. Të hyrat në lokal-in-bastoren "Euro Best" fsh. B. K. D., gusht 2010, tetor 2010, prej 4.761,00 euro.

13. Të hyrat në lokal-in-bastoren "Euro Best" fsh. B. K. D., prill 2008, qershor 2011, prej 42.127,00 euro.

14. Të hyrat në lokal-in-bastoren "Euro Best" K. B. Prizren, shtator 2008, qershor 2011, prej 17.780,00 euro.

15. Të hyrat në lokal-in-bastoren "Toto Sport" B. Prizren, nëntor 2007, qershor 2011, prej 81.573,00 euro.

16. Të hyrat në lokal-in-bastoren "Te Elita", rruga... Prizren, prill 2010, nëntor 2011, prej 1.936.368,00 euro.

17. Të hyrat në lokal-in-kazino-bastore S., korrik 2010, shtator 2011, prej 50.757,00 euro.

19. Të hyrat në lokal-in-kazino-bastore ...Prizren, gushtë 2010, qershor 2011, prej 28.623,00 euro.

20. Të hyrat në lokal-in-bastore sportive, vendi i pa njohur në Prizren prill 2008 tetor 2008, prej 232.486,00 euro.

I akuzuari nga veprimtaria e pa licencuar sipas raportit të ekspertit financiar B. I. ka realizuar të ardhura të kundërligjshme në lartësi prej 2.736.311,00 euro.

Me këtë ka kryer veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 243 paragraf. 2 të KPK-së.

II. Se në kohën dhe vendin e njejtë si në pikën 1 të kësaj aktakuye, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së lojrave të fatit, të kazinove dhe të lojrave të tjera, me qëllim i shmanget tërësisht pagimit të tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera, të përcaktuara me ligj, jep të dhëna të pavërteta për të ardhurat e veta të cilat nuk i përfshinë në informatat lidhur me të ardhurat e tij, gjendjen ekonomike, për vlersimin e detzrimeve nga kjo veprimtari, ashtu që detyrimet e të pandehurit arrijnë shumën prej 660.616,00 euro.

Me këtë ka kryer veprën penale shmangia nga tatimi nga neni 249 paragrafi 2, të KPK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartshënuar 4, 7, 17.1 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 73, 75 paragrafi 1 pika 1.3 si dhe nenit 243 paragraf. 2 lidhur me paragrafin 1, dhe 249 paragrafi 2 të KPK-së, të akuzuarin e:

## **GJYKON**

Për veprën penale nën I. të dispozitivit ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6(gjashtë) muaj burgim, dhe

Për veprën penale nën II të dispozitivit dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6(gjashtë) muaj dhe,

dënimin me gjobë në lartësi prej 2000 (dymijë) euro.

Në kuptim të nenit 80 të akuzuarit i shqiptohet

### **DËNIMI UNIK**

Me burgim në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 2 (dy) viteve nuk kryen veprë të re penale, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, nga data 24.04.2018 e deri më datën 02.07.2018 në rast të revokimit të dënimit me kusht dhe,

Dënimin me gjobë në lartësi prej 2.000 (dymijë) eurove të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Në rast se i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguaj gjobën atëherë dënimin me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do të caktohet një ditë burgim.

E dëmtuara Administrata Tatimore e Kosovës për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet që i akuzuari të paguajë shpenzimet e procedurës në lartësi prej 450(katërqind e pesëdhjetë) euro, si dhe 50 (pesëdhjetë) euro në emër të Fondin për kompenzimin e viktimave të krimit, krejt këto në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren ka paraqitur aktakuzën PP.nr.46 76/12-II të datës 09.06.2014, si dhe me datën 27.06.2018 ka parashtruar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë PP/I nr.4676/12-II - ndaj të akuzuari Y. K., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 243 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së dhe veprës penale shmangia nga tatimi nga neni 249 par.2 të KPK-së.

Prokurori i shtetit gjatë seancës së shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se në përputhje me kushtet e parapara me ligj në prezencë të mbrojtësit dhe të akuzuarit kanë negociuar dhe arritur marrëveshjen e pranimit të fajësisë ku paraprakisht sikurse edhe në këtë seancë gjyqësore e ka paralajmëruar të akuzuarin se është duke hy në marrëveshje për pranimin e fajësisë me vullnet, mos eventualisht ka ndonjë presion apo ndikim tjetër të paligjshëm i njëjti në prezencën e mbrojtësit të tij ka deklaruar se është konsultuar me mbrojtësin e tij që të hy në marrëveshje se është duke hy në marrëveshje me vullnet, se është konsultuar për pasojat e arritjes së kësaj marrëveshje. Prokurori në vazhdim ka deklaruar se mbes

pranë kësaj marrëveshje të arritur nën kushtet dhe në lartësinë e sanksionit penal sikurse edhe në marrëveshje. Prokurori i shtetit ka deklaruar se para se të arrinin marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ka bërë ricilësimin e aktakuzës ku të akuzuarin e ka akuzuar për veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm nga neni 243 paragrafi 2 e jo siç ka ekzistuar në aktakuzë me paragrafin 3 të këtij neni.

Mbrojtësi i të akuzuarit avokati A. R. gjatë seancës ka kërkuar nga gjykata që të pranojë marrëveshjen e pranimin të fajësisë, e cila është negociuar nga ana e prokurorit të shtetit, ku kjo marrëveshje është mbështetur edhe në deklarin nga ana e të pandehurit, i cili ka kuptuar pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë mbështetet në vullnet dhe e njejtë është edhe në provat materiale, të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe nga rikualifikimi i veprës penale, për të cilën e kemi nënshkruar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, gjithashtu ka gjithashtu ka kërkuar që dënimin të cilin do ta shqipton ndaj të pandehurit, ta orienton si një marrëveshje duke i propozuar që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, t'i merr parasysh rrethanat siç janë pranimi i fajësisë, koha e kaluar nga kryerja e veprës penale, si dhe i njejtë nuk ka ra ndesh me ligjin dhe nuk ka kryer vepra penale duke premtuar se edhe në të ardhmen nuk do të kryer vepra penale të ngjashme apo të tjera.

Sa i përket gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar ashtu si është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi në kushtet dhe rrethanat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

Pas dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, gjykata konstatoi se i akuzuari Y. K. ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij avokati A. R., gjykata ka konstatuar se i akuzuari në asnjë mënyrë nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar ta pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret të cilat janë paraqitur në aktakuzë të pranuar edhe nga i akuzuari dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat që parashihen në dispozitat e nenit 253 par.1 dhe 2 të KPP-së mbi marrëveshjen e pranimin të fajësisë.

Lidhur me dënimin prokurori i shtetit ka qëndruar pranë dënimin të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe ka shtuar se pajtohet që gjykata me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin t'i merr parasysh dispozitat për zbutjen e dënimin duke pasur parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit dhe vet i akuzuari lidhur me dënimin kanë deklaruar se qëndrojnë pranë dënimin të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, gjithashtu gjykata në rastin konkret ka aplikuar dispozitat e nenit 75 për zbutjen e dënimit dhe atë për faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, e gjithashtu gjykata konsideroi se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese që tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë, kjo për faktin se i akuzuari ka arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë, sikurse edhe rrethanat personale të akuzuarit, se i njejtë është i martuar, baba i 2 fëmijëve, është i moshës relativisht të re, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, dhe se në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KP dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon akuzuari dhe se me këtë dënim i akuzuari do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëhet rehabilitimi i tij, e gjithashtu do të parandalohen edhe personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 450, dhe 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
PKR.nr. 176/16 me datë 02.07.2018

Procesmbajtësja  
Birsen Kume

Kryetari i trupit gjykues  
Skender Çoçaj

**UDHËZIM JURIDIK:** Ndaj këtij aktgjykimi palët nuk kanë të drejtën e ankesës sa i përket vendimit mbi dënimin dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankesa për bazat tjera mund të ushtrohen në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.